



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2017
Nr. Dok. 201700726/2

Lënda: Rekomandojmë marrjen e masave për përmirësimin e shërbimeve të ofruara për fëmijët në nevojë në Shtëpinë e Fëmijës 6-18 vjeç, Shkodër

Drejtuar: Znj. Voltana Ademi
Kryetare e Bashkisë Shkodër

Znj. Merita Xhafaj
Drejtoreshë e Përgjithshme
Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Tiranë

Znj. Etleva BISHA
Shërbimi Social Shtetëror
Drejtoreshë e Përgjithshme

Tiranë

Z. Gëzim Mahmutaj
Drejtor i institucionit

Shkodër

Seksioni i Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, në zbatim të urdhrit të Avokatit të Popullit Nr. 51, datë 03.04.2017, kreu një inspektim të përgjithshëm në Shtëpinë e Fëmijës 6-18 vjeç Shkodër më datë 08.06.2017. Avokati i Popullit pasi shqyrtojë informacionin nga monitorimi i realizuar ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrorë konkluzionet përfundimtare.

Objektivat e inspektimit:

- Respektimi i të drejtave të të fëmijëve në zbatim të Konvetës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.
- Monitorimin e zbatimit të të drejtave të fëmijëve me fokus përfshirjen e fëmijëve në vendimarrje.
- Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga institucioni i Avokatit të Popullit nga inspektimi i fundit.

Metodologjia

Grupi inspektues i institucionit të Avokatit të Popullit, i përbërë nga një juriste dhe një punonjës social, si metodologji pune ka përdorur:

- Zhvillimin e bisedave paraprake me drejtuesit e këtyre institucioneve, informacion i cili është hedhur në një formular standard për inspektimet e këtyre institucioneve.
- Kontrollin 2 dosjeve në mënyrë rastësore të përfituesëve të institucionit.
- Kryerjen e intervistave në grup me fëmijët me qëllim krijimin e një perceptimi sa më të plotë të trajtimit të tyre në këtë qendër ku theksi u perqëndrua tek përfshirja e fëmijëve në vendimarrje duke eksperimentuar indikatorin “*Vleresimi dhe pikëzimi përmes një shëtitjeje në shërbim*”.

Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues i Institucionit të Avokatit të Popullit ka kryer bisedën përmbyllëse me drejtuesin e institucionit dhe stafin në shërbim të drejtëpërdrejtë me përfituesit, ku u adresuan problematikat e evidentuara gjatë inspektimit ku u lanë edhe rekomandimet përkatëse, të cilat gjenden të detajuar në fund të raportit.

SHTËPIA E FËMIJËS 6-18 vjeç SHKODËR

Tipologjia: Shërbim i përkujdesit social rezidencial,

Drejtuesi: Z. Gëzim Mahmutaj
Drejtor i institucionit

Nr i stafit: 24 punonjës

Nr i përfituesve: 23 përfitues

Shërbimet që ofrohen në këtë qendër janë:

- Plotësimi i nevojave bazë ushqim, strehim ,veshmbathje
- Plotësimi i nevojave shëndetsore
- Shërbime psiko-sociale
- Terapi grupi dhe pune okupacionale
- Pjesmarrje në aktivitete kulturore

Kontrolli i performancës administrative dhe organizative

Shtëpia e Fëmijës 6-18 Shkodër, është licensuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit për ofrimin e shërbimeve të përkujdesit social rezidencial për fëmijët në nevojë. Ky institucion në zbatim të VKM nr 710 dt 24.10.2007 është nën varësinë administrative të Bashkisë Shkodër ndërsa organograma e institucionit është në zbatim të Urdhërit Nr 88¹ dt 25.10.2011 të Kryeministrit ku është përcaktuar organika me pozicionet e punës kategoritë përkatëse të punonjësve dhe numrin e tyre si me poshtë vijon:

1 Drejtor
1 Përgjës i sektorit social (Punonjës Social)
1 Psikolog
5 Specialist (edukator)
9 Kujdestar
1 Përgjegjës i sektorit administrativ
2 guzhunier

¹ Urdhëri KM nr.252 date 1.11.2006; Urdhëri Nr.64 i Kryeministrit date 23.03.2010 ; Urdhëri i Kryeministrit nr. 88, date 25.10.2011 ; Urdhëri nr. 150 I Kryeministrit datë 27.12.2012

1 punëtor mirëmbajtës
3 pastrues
24 punonjës gjithësej

Në ambinetet e institucionit është afishur rregullorja e ardhur me e-mail nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror (rregullore e përgjithshme tip për institucionet e përkujdesit social për fëmijët të grupmoshës 6-18 vjeç). Kjo rregullore pavarësisht se është e afishur nuk ka fuqi juridike sepse nuk është e miratuar nga Bashkia Shkodrës. Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të institucionit duhet të hartohet në përputhje me treguesit e cilësisë numër 3.2 të standardit 1 të VKM Nr. 659, datë 17.10.2005 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale” ku thuhet se *“Ka një rregullore të brendshme ku përcaktohen qarte dhe hapur rregullat e jetesës në shtëpi si për fëmijët dhe stafin”*.

Nga të dhënat sasiore dhe cilësore të kontrolluara në këtë institucion trajtohen 23 përfitues, 21 fëmijë “jetim social” dhe 2 fëmijë jetim biologjik. Fëmijët “jetim social” gjenden në një a më shumë situata rreziku, faktori dominues që ndikon është varfëria, familjet disfunktionale, familjet me probleme sociale si varësitë nga substancat, alkooli dhe bixhozi, familjet me probleme shëndetësore, etnia dhe një kombinim i një a më shumë prej këtyre faktorëve. Fëmijët sipas gjendjeve civile dhe vendbanimit janë 14 fëmijë nga Bashkitë Pukë, Tropoja, Mirditë, Tiranë, Librazhd, Lezhë, Durrës dhe 9 fëmijë janë nga Bashkia Shkodër. Fëmijët frekuentojnë shkollat publike të qytetit të Shkodrës ndërsa 9 fëmijë shkojnë në shkollën special “3 Dhjetori” për shkak të aftësisë së kufizuar kjo e papaërcaktuar me Vendim Komisioni të Aktimit të Aftësisë së Kufizuar për Punë. Shumë prej fëmijëve në këtë institucionin urinojnë natën dhe trajtoheshin me medikamente mjeksore (imporaminë).

Nga kontrolli i dokumentacioneve shërbimet e ofruara në këtë institucion janë (i) akomodim (ii) ushqim (iii) këshillim psiko-social të ofruara nga psikologjia (iv) edukim/arsimim (v) shërbim shëndetësor. Jeta sociale ku fëmijët merrnin pjesë në aktivitete të ndryshme si kurset e gjuhëve të huaja, kurset e muzikës, kitara, piktura, dancit etj tashmë nuk realizohen si pasoje e mungesës së donacioneve të cilat siguroheshin nga një shoqatë Italiane. Aktivitetet mujore dhe javore të pasqyruara në planin e punës të sektorit social konsistojnë në biseda të lira me edukatorët, lojra sportive në ambientet e jashtme të institucionit, leximin e librave, kurset e hembollit ku merrnin pjesë 4 vajza etj.

Të dhënat e lartë përmendura tregojnë qartë profilet e fëmijëve, përfitues të Shtëpisë së fëmijës, Shkodër, ky përveç ngjarjeve traumatike në jetën e fëmijëve në të shkuarën i shtohen edhe institucionalizimi që lidhet drejtëpërsëdrejti me traumën e braktisjes, transferimit të tyre nga vendbanim ku kanë jetuar në një vendbanim të ri, izolimit të tyre duke mos qënë pjesëmarrës në vendimarrje, segmentizimit të shërbimeve vetëm për të plotësuar nevojat bazë të tyre dhe mos garantimi i vazhdimësisë së aktiviteteve të nisura si rezultat i largimit të donatorëve.

Nga analiza krahasuese e vlerësimit të shërbimeve që ofrohen në institucion dhe profilit të përfituesëve si dhe në zbatim të nenit 25 Konvetës “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve” dhe në zbatim të *Udhëzimit Nr. 14, datë 10.5.2016 “Për ofrimin e shërbimit të emergjencës në institucionet e përkujdesit shoqëror të financuara nga fondet e buxhetit të shtetit publik që ofrojnë shërbime të përkujdesit rezidenciale për fëmijët në nevojë”* është e rëndësishme të vlerësohen nevojat e fëmijëve lidhur me shërbimet që duhet të ofrohen

përpara institucionalizimit . Në këtë kontekst për të parandaluar institucionalizimin e fëmijëve dhe qëndrimin afatgjatë në shërbime rezidenciale kërkohet zbatimi i praktikave të mira të kujdesit të fëmijës në interesin më të lartë të fëmijës nga të gjithë aktorët në nivel vendor dhe rajonal të cilët punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.

Fondet për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së institucionit sigurohen nga buxheti qendror i shtetit, programi i përkujdesjes sociale, MMSR, fond i kushtëzuar, i cili i çelët direkt institucionit nëpërmjet Bashkisë Shkodër.

Gjatë intervistës së realizuar me stafin e lidhur me varësinsë e institucionit, u informuam se institucioni kishte “varësi të dyfishtë”, terminologji e përdorur edhe nga stafet e institucioneve të tjera të përkujdesit social të cilat janë nën varësinë administrative të Bashkive.

Nga intervista e thelluara e realizuara nga ekipi i monitorimit u arrit në përfundimin se kjo terminologji nënkupton:

“Varësi e dyfishtë” e institucioni sepse (i) Bashkia Shkodër është përgjegjëse për menaxhimin dhe administrimin e shërbimit por institucioni nuk mund të ushtrojë veprimtarinë e vetë, pa burimin kryesor, “**fondet**” të cilat planifikohen dhe transferohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror (MMSR). Pikërisht, në këtë kontekst kjo “varësi e dyfishtë” ka qënë faktor i rëndësishmë i cili ka rreth 10 vjet që ka mbajtur peng këtë institucion për të mos patur asnjë lloj progresi në kuadër të përmirësimit të cilësisë së shërbimit por duke trashëguar një model të vjetër si në infrastrukturë dhe në ofrimin e shërbimit të përkujdesit ndaj fëmijëve.

Për të qartësuar terminologjinë e përdorur nga shumë institucione të përkujdesit social të cilat janë nën varësinë administrative të bashkive dhe duke realizuar një analizë më të thelluar të problemit të ngritur për të kuptuar nëse janë “parashikimet e kufizuara të fondeve nga qeverisja qendrore” ose “paaftësia e qeverisjes qendrore për të planifikuar këto fonde për të arritur synimet e kërkuara” apo është “paaftësia e qeverisjes vendore për të menaxhuar dhe administruar shërbimet sociale”, ekipi i kontrollit elaborojë të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore lidhur me parashikimin e fondeve të transferuar për institucionet e përkujdesit social.

Fondet nga buxheti i shtetit të cilat i transferohen me transfertë të kushtëzuar institucioneve të përkujdesit socialë janë të detajuar për zërat:

- “pagat” sigurime shoqërore të specifikuar për çdo pozicion pune sipas strukturave të miratuara me Urdhërit Nr 88² dt 25.10.2011 të Kryeministrit të ndryshuar në këto 10 vjet 4 herë. Ky zë është përcaktuar sipas klasifikimit, kategorisë së pozicioneve të punës dhe paga bazë e caktuar sipas tabelës së pagave, shtesa për funksion, shtesë për vjetërsi në punë dhe shtesa për vështirësi në punë.
- “Ushqim” i përfituesëve, ku norma ose kuota financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve të përfituesëve në institucionet e përkujdesit social është e përcaktuar në Udhëzimin Nr. 5, datë 1.8.2012 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror”

² Urdheri KM nr.252 date 1.11.2006; Urdhëri Nr.64 i Kryeministrit date 23.03.2010 ; Urdheri i Kryeministrit nr. 88, date 25.10.2011 ; Urdhëri nr. 150 I Kryeministrit datë 27.12.2012

- “Para në të holla” që ju jepen përfituesëve në institucione është e përcaktuar në zbatim të VKM Nr 114 datë 31.1.2007 “Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave, që vendosen në institucionet rezidenciale publike, të shërbimeve të përkujdesit shoqëror”, i ndryshuar.
- “shpenzimet operative” përfshin shpenzimet për energji, ujë, ngrohje, detergjentë, medikamente, shpenzime të tjera sipas natyrave të klientëve, artikuj shkollor, kancelari administrate, shpenzime udhëtim-dieta, etj. Ky është i vetmi zë i paparashikuar.

Për të gjitha institucionet e përkujdesit social, Drejtoria e Përgjithshme e SHSSH bën vlerësimin, duke i krahasuar edhe me numrin e përfituesve që ka aktualisht institucioni me atë që kërkon të planifikojë si dhe duke parë realizimin e shpenzimeve në vitin aktual me atë që ka parashikuar për vitin pasardhës.

Nga vlerësim i analizës disa prej rregullimeve financiare në kuadrin e përmirësimit të legjislacionit janë të mirëpërcaktuar. Janë përcaktuar disa prej rrugëve të financimit të shërbimeve sociale të cilat japin orientimin se “çfarë duhet të financohet me këtë fond?”; “Cilat janë zërat e përcaktuara në burimet e financimit?” “çfarë pjese e financimit mund t’i lihet pushtetit vendor”.

Në zbatim të akteve ligjore, ku bashkitë janë përgjegjëse për administrimin e institucioneve të përkujdesit social ka hapësira ku pushteti lokal të financojë shërbimet sociale nga të ardhurat e vetë pushtetit lokal, kjo edhe në procesin e planifikimit afatmesëm për krijuar mundësinë e, “realizimit të një analize të thelluar të nevojave për shërbime brenda territorit të tyre me vizion të qartë për ofrimin e tipologjive të reja të shërbimeve apo me filozofine e transferimit të këtyre institucioneve nga shërbime sociale rezidenciale në shërbime të ndryshme sociale si fuqizimi i familjes, kujdestaria e përkohshme, shërbimi i emergjencës të parashikuar tashmë në ligjin Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr.9232 datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, i ndryshuar, VKM 405 datë 01.06.2016 “Për miratimin e Strategjisë së Strehimit Sociale” 2016-2025.

Për sa më sipër dhe në zbatim të Kushtetutës së RSH, ku përcaktohet që qeveria lokale krijohet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore – Neni 13 i Kushtetutës, në kuptim të këtij përcaktimi, ofrimi i shërbimeve shoqërore bazohet në parimin e decentralizimit, konkludojmë se baza ligjore është pjesërisht e kompletuar dhe sa më shpejt të jetë e mundur të hartohen aktet nënligjore të cilat duhet të adresojnë kompetencat e gjithsecilit nga aktorët dhe masat konkrete për të siguruar zbatimin e ligjit dhe shkeljet ose moszbatimin e tij. Në këtë kontekst e rëndësishme është që Bashkia Shkodër të marrë masa për vlerësimin e nevojave për shërbime sociale dhe hartimin e planit social të buxhetuar, ku të fillojnë procedurat për financimin e tyre nga vetë fondet e bashkisë dhe në bashkëpunim me buxhetin e shtetit ku zërat janë të caktuara.

Pjesëmarrja e fëmijëve në vendimarrje

Informacion u sigura gjatë përdorimit të indikatorin “Vlerësimi dhe pikëzimi përmes një shëtitjeje në shërbim”. me fëmijët. Fëmijët u përzgjedhën në mënyrë rastësore dhe së bashku me përfaqësuesit e Avokatit të Popullit realizuan një shëtitje në institucion ku fëmijët udhëhoqën këtë vizitë duke treguar ambientet e institucionit, dhe për çfarë shërbente cdo ambiente. Në fund të shëtitjes fëmijët vizatuan ambientet e institucionit duke vlerësuar cdo ambiente me shënja “+”, “x” “?” për cdo shërbim që ofrohej në këto ambiente.

Jeta e fëmijëve në institucion fillon me zgjimin e tyre, higjienen personale (te djemte le shumë për të dëshiruar), ushqimin, nisjen dhe kthimin nga shkolla, ofrimi i vaktit të drekës, studimi, zemra dhe koha e lire e cila konsistonte me shumë në lojrat me top në ambientet e jashtme të institucionit, bisedave të lira brenda dhomave të studimit dhe darka.

Gjatë realizimit të këtij procesi fëmijët e ndjenin shume mungesën e aktiviteteve social-kulturore (kursi i muzikës, kitarës, dancit, pikturës etj) në të cilat kishin marrë pjesë dhe ndiheshin shumë mirë me mësuesit të cilët kishin realizuar këto aktivitete. Vlerësimi i ulët ishte për aktivitetet që zhvilloheshin brenda institucionit të cilat nuk ishin shumë të kenaqëshme për fëmijët. Fëmijët dhe prindërit e tyre s’ishin aspak të përfshirë gjatë procesit të vlerësimi social-psikologjik-shëndetësor të tyre dhe hartimit të planit të përkujdesjes nga ekipi multidisiplinar Kjo e evidentuar edhe në dosjet e përfitueseve dhe regjistrin e takimeve me prindërit ku ka mungesë të një plani prindër-fëmijë. Marrja e informacioneve nga palët e treta (bashkë të jetojnë prindërit, njësite për mbrojtjen e fëmijëve etj) lidhur me prindërit e fëmijëve, punë e cila kishte filluar të zbatohet nga sektori social në këtë institucion për të mundur përfshirjen e prindërve në programe këshilluese për prindërim të përgjegjshëm.

Gjithashtu gjatë procesit u identifikuan disa vështirësi që shfaqnin fëmijët të tilla si problem me vëmendjen, problem në artikullim, agresivitet verbal, fizik kundrejt njëritjetërit (fëmijët më të mëdhenj kundrejt fëmijëve më të vegjël), fjalor i kufizuar, kontakt viziv i reduktuar, tërheqje, pasiguri për të ardhmen. bulizmi.

Avokati i Popullit është i shqetësuar se pjesëmarrjen e fëmijëve në vendimarrje gjatë trajtimit të fëmijëve në institucion e përkujdesit social e kuadratojnë brenda standardeve të shërbimeve të përkujdesit social ku është e parashikuar në hartimin e menysë ushqimore, në vlerësimin e nevojave dhe hartimin e planit të përkujdesjes (kane filluar përpjekjet për duhet të bëhet më shumë). Në zbatim të nenit 12 të Konvetës “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” ku parashikohet e drejta për t’u dëgjuar zëri i fëmijëve dhe pjesëmarrjen e tyre në vendimarrje në të gjitha aspektet e veprimtarisë të institucionit për cdo vendim që merrret në të, fëmijët duhet të pyeten, të dëgjohen duke ja shpjeguar në një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme sipas zhvillimit të tyre duke vlerësuar mendimin e tyre si edhe duke i bërë pjesë të vendimarrjes p.sh gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të rregullores së institucionit, gjatë hartimit dhe miratimit të planit të punës së aktiviteteve social-kulturore etj.

Vlerësimi Social-Psikologjik-Shëndetësor-arsimor i fëmijëve në institucion

Grupi i monitorimit kontrollon dy dosje në mënyrë rastësore të cilat përmbanin dokumentat bazë të pranimit me vendim komisioni dhe të gjitha dokumentacionet e përcaktuara në VKM Nr 425

datë 27.6.2012 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jopublike, të përkujdesjes shoqërore”, i ndryshuar. Konkretisht u kontrolluan dosjet e fëmijëve me inicialet A.T dhe fëmijës me inicialet F.T.

Me poshtë informacioni i marrë nga kontrolli i dy dosjeve rastësore:

1. Në dosjen e përfituese me inicialet A.T të gjitha rubrikat e plotësuara në RNVE (format i cili përdoret për vlersimin e nevojave social-psikologjike-shendetesore-arsimore vlersimi i fëmijës është “shumë mirë”, vlersim i cili nuk përputhet me nevojat e fëmijës realisht. Konkretisht fëmija me inicialet A.T kishte realizuar vlersimin psikologjik nga një psikolog-ja Artemisa Shehu/Dono ku është shprehur se *“fëmija me inicialet A.T ka probleme me sjelljen e saj kundrejt rregullave dhe autoritetit të cilat e bëjnë të predispozuar të zhvillojë sjellje agresiviteti ndaj të rriturve dhe moshatarëve. Gjithashtu paraqet vonesë të lehtë mendore”* shërbimi i cili është mundësuar nga organizata “Shpresë për Botën”. Gjithashtu në këtë vlerëim vlen për t’u theksuar se fëmija shprehte dëshirën për t’u kthyer në familjen e saj (tek e ema me te cilën fliste ne telefon) së bashku me vëllezrit e saj, *“e vetmja shpresë që e mbante gjallë”*. Nga vlerësimi psikologjik i kryer është rekomanduar *“trajtimi i fëmijës me inicialet A. T me ofrimin e shërbimit terapi zhvillim”*, shërbim i cili nuk ofrohet në institucion. Psikolog-ja e institucioni Senida Dragusha zhvillonte këshillime individuale me fëmijën A.T por këto janë të fokusuara në raste kur fëmija A.T ka krjuar situata kritike (sjellje agresivitetit) jo vetëm me stafin por edhe me fëmijët e tjerë. (praktika të cilat nuk ndodheshin në dosje e përfituesit por në kompjuterin e psikologes e cila na i vuri ne dispozicion). Dosja e përfituese nuk përputhet me vlersimin real të fëmijës dhe punës konkrete qe psikolog-ja së bashku me stafin e qendrës punojnë, kjo e pashkruajtur në rubrikat përkatëse të RNVE-së, e padokumentar si dhe fëmija nuk është përfshirë vendimarrje, gjatë hartimit të planit të përkujdesjes siç është parashikuar në standaritin 2, të VKM Nr. 659, datë 17.10.2005 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”.

Në dosjet e përfituesve është e rëndësishme të mblidhen informacione nga palët e tjera p.sh njësitë për mbrojtjen e fëmijës, policia, bashkë kur fëmijët janë me vendbanim jashtë Bashkisë Shkodër të cilat janë shumë të rëndësishme të ndahen edhe me fëmijët dhe tju shpjegohen në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për ti ndihmur ata në planin e rrugës për të ardhmen.

2. Nga vlerësimi i dosjes së fëmijës me inicialet F.T nga ekipi i kontrollit ku u kontrollua cdo rubrike e plotësuar e formatit RNVE dhe planit të përkujdesjes, merrje mesazhin që *“ky fëmijë reflekton sjellje normale dhe progres në realizimin e aktiviteteve të parashikuara në planin e përkujdesjes”*.

Nga intervista e realizuar me fëmijën u informuam se fëmija nuk është në dijeni të egzistencës së dosjes së tij, planit të përkujdesjes e jo më të ketë qënë pjesë gjatë vlersimit të nevojave dhe hartimit të planit të përkujdesjes. Për fëmijën me inicialet F.T shumë fëmijë të tjerë më të vegjël në moshë kishin ankesa për dhunën që ushtronte kundrejt tyre, e pa-reflektuar në rubrikën përkatëse si *“fëmijë me sjellje agresive ndaj fëmijëve të tjerë”*. Staf i për cdo incident të këtij fëmije mbante proces-verbal dhe informonte sektorin social por keto sjellje ishin të pranishme ne cdo ditë dhe shqetësuese.

Gjithashtu gjatë vezhgimit të ambientëve të institucionit dhoma në të cilën qendronte femija me inicialet F.T kishte problem të theksuara të higjenës dhe pastërtisë. M.q.s është 17 vjec është e rëndësishme të fillonte puna për hartimin e “Planit e Rrugës për të Ardhmen”. Staf i sqarojë se në bashkëpunim me shoqatën

“Save the children” ka nisur puna për fuqizimin e familjes së tij në Tiranë, dëshirë jo vetëm e këtij përfituesi por edhe motrës së tij. Avokati i Popullit shpreh shqetësimin maksimal për integrimin e ketyre dy fëmijëve për vetë faktin se nga informacioni i marrë nga ogranizata të ndryshme nëna e tyre ka shumë probleme të cilat duhet të vlersohen me rigorozitet nga organet kompetente ndërkohë që fëmijët s’janë të informuar dhe shpresojnë së një ditë do të bashkohen më nënë e tyre. Në vazhdimësi kjo do të jetë një traum tjetër për fëmijët dhe e ardhmja e tyre është e rrezikuar.

Nga kontrolli i punës së sektorit social vihet re se janë bërë përpjekje të plotësohen modulet e planit të përkujdesit për çdo fëmijë dhe RVNE –të. Plotësimi i rubrikave të RNVE janë subjektive të cilat nuk të ndihmojnë për të hartuar një plan përkujdesjes i cili të jetë në ndihmë të trajtimit të fëmijëve në institucion dhe të ofrohen shërbimet e duhura për ta. Por edhe në rastet kur këto vlerësime janë realizuar nga eksperte të tjerë jashtë institucionin këto nuk bëhen pjesë e dosjes. Vlersojmë punën dhe angazhimin e stafit për përpjekjet e tyre në përmbushjen e detyrave funksionale por është e rëndësishme të punohet me shumë seriozitet në plotësimin e të gjitha rubrikave të RNVE-ve dhe planit i përkujdesjes sipas treguesve dhe udhëzuesve perkatës, të parashikuara në VKM Nr. 659, datë 17.10.2005 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”. Ndjekja e ketyre praktikave të mirat të punës do të ndihmojnë në një vlersim më të mirë të nevojave dhe hartimin më me efikasitet të planit të përkujdesjes, ku fëmija duhet të jetë i pranishëm dhe pjesëmarrës në vendimarrje dhe mundësi që institucioni ose institucione të tjera kanë për të garantuar një zhvillim me parametra norma të fëmijës në interesin më të lartë të tyre.

Avokati i Popullit vlerëson punën e realizuar nga institucionet përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të përkujdesit social për fëmijët në nevojë, ku në kuadër të procesit të decentralizimit është plotësuar dhe përmirësuar kuadri ligjor si ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr.9232 datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, i ndyrshuar, dhe dokumentat politike si VKM-ja 405 datë 01.06.2016 “Për miratimin e Strategjisë së Strehimit dhe Strategjia Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2015-2020 Më tej, Avokati i Popullit shpreh shqetësim lidhur me kapacitetin e dobët në përgjithësi lidhur me zbatimin efektiv të ligjeve që trajtojnë çështje të fëmijëve në nivelet rajonale dhe ato bashkiake.

Në zbatim të nenit 21 të ligjit **Nr.8454, datë 4.2.1999, ”Për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë”**, i ndryshuar “*paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”;

REKOMANDIMË:

1. Marrjen e masave për hartimin e akteve ligjore në zbatim të ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. (MMRS)
2. Marrjen e masave për vlerësimin e nëntë fëmijëve që shkojnë në shkollën speciale “3 Dhjetori” nga komisionet e përbëra nga mjekë, psikologë, mësues dhe specialist për fëmijët e aftësi të kufizuar të ngritura pranë të gjitha njësive arsimore vendore, në zbatim të pikës 3, të nenit 64, të ligjit Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor

- parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, regjistrimi i tyre në shkollat publike të qytetit. *(Shtepia e Femijes 6-18 vjec Shkoder)*
3. Ngritjen e një grupi pune ndërsektorial ku në përbërjen e tij të ketë përfaqësues nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve , Shërbimi Social Shtetëror dhe Inspektoriat i Shërbimeve Shoqërore për të realizuar monitorimin tematik mbi zbatimin e Udhëzimit Nr. 14, datë 10.5.2016 “Për ofrimin e shërbimit të emergjencës në institucionet e përkujdesit shoqëror të financuara nga fondet e buxhetit të shtetit publik që ofrojnë shërbime të përkujdesit rezidenciale për fëmijët në nevojë” me qëllim vlerësimin e efikasitetit të bashkërendimit dhe bashkëpunimit të punës ndërmjet strukturave të cilat kanë varësi të ndryshme institucionale. *(MMSR)*
 4. Bashkia Shkodër ti japë më shumë prioritet parametrave të kujdesit alternative, shërbimit të kujdestarisë sesa vendosjes në institucionet rezidenciale fëmijëve në nevojë duke rritur ndërgjegjësimin e publikut për ofrimin e shërbimit të kujdestarisë (rritjen e numrit të familjeve që do të ofrojnë shërbimin e kujdestarisë) si dhe ndikimeve negative që ka në zhvillimin e fëmijës vendosja në institucione e përkujdesit social rezidencial.
 5. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror të marrë të gjitha masat e nevojshme për të ulur vendosjen e fëmijëve në Shtëpinë e Fëmijës, Shkodër 6-18 vjec, veprim i cili do të ulë kohëqëndrimin e fëmijëve në këtë institucion duke mundësuar ofrimin e tipologjive të reja të shërbimeve sociale për parandalimin e institucionalizimit të fëmijëve nga Bashkia Shkodër.
 6. Bashkia Shkodër për fëmijët që kanë vendbanimin në këtë bashki të planifikojë dhe të bashkëpunojë me organizatat jo-qeveritare për të krijuar programe mbështetëse për prindërit dhe kujdestarët që synojnë krijimin dhe prezantimin e praktikave të mira për mirëritjen e fëmijëve, bazuar në njohjen e të drejtave të fëmijëve, zhvillimin e tyre dhe teknikat disiplinore positive, që synojnë mbështetjen e familjeve për t’u siguruar fëmijëve kujdes dhe një mjedis të sigurtë;
 7. Stafi i Shtëpisë së Fëmijës Shkodër duhet të përforcojnë përpjekjet me synim që fëmijët të kenë të drejtë të shprehin lirshëm mendimet e tyre në të gjitha çështjet që lidhen me ta dhe të jenë pjesëmarrës në vendimarrje e pasqyruar edhe në dosjet e tyre personale.
 8. Marrjen e masave për plotësimin e rubrikave të RNVE me profesionalizëm i cili do të sjell evidentimin e nevojave të vecanta për fëmijët të cilat do të ndihmojnë në hartimin e planit të përkujdesjes me efikasitet në interesin më të lartë të fëmijës. *(Shtepia e Femijes 6-18 vjec Shkoder)*
 9. Marrjen e masave të plotësimit e të gjitha rekomandimeve të lëna për psikolog-ja Artemisi Shehu/ Dono për fëmijën me inicialet A.T, e rëndësishme fillimi i terapisë së zhvillimit. *(Bashkia Shkoder&Shtepia e Femijes 6-18 vjec, Shkoder)*
 10. Marrjen e masave për të mundësuar një mentor për fëmijën me inicialet F.T, shërbimi i cili mundëson ndryshimin e sjelljeve negative dhe të patolerueshme.
 11. Marrjen e masave për hartimin dhe miratimin e rregullores së institucionit në përputhje me treguesit e cilësisë të parashikuar në VKM-në Nr. 659, datë 17.10.2005 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale” dhe Udhëzimin në zbatim të këtij Vendimi. . *(Bashkia Shkoder&Shtepia e Femijes 6-18 vjec, Shkoder)*

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një

rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”.Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe në vijimësinë e bashkëpunimit në funksion të garantimit të të drejtave të fëmijëve.

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI